



Raport Konsultativ

Shqyrtimi i Nëntë i Tarifave të Energjisë Elektrike

SHTE9 (2015-2016)

Llogaritja e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) dhe Ngarkesave të
Gjeneratorit të Rregulluar (Viti Relevant 3)

DEKLARATË

Ky Raport Vlerësimi është përgatitur nga ana e ZRRE-së me qëllim të informimit të palëve të interesuara. Raporti nuk paraqet ndonjë vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të interpretohet si tillë.

09 mars 2015



Përmbajtja

| | | |
|----------|---|-----------|
| 1 | Pasqyrë e Përcaktimit të Çmimit | 4 |
| 2 | Hyrje..... | 5 |
| 3 | Vlerësimi i ZRRE-së për MAR e Gjeneratorit të Rregulluar | 5 |
| 3.1 | Kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes (OPMct) | 6 |
| 3.1.1 | Norma e aplikueshme e inflacionit..... | 6 |
| 3.1.2 | Aplikimi i faktorit të efikasitetit në kostot OTFct të KEK-ut | 7 |
| 3.1.3 | Vlerësimi final i ZRRE-së të komponentës së OPMct | 7 |
| 3.2 | Zhvlerësimi i lejuar (DEPct)..... | 7 |
| 3.3 | Kthimi i lejuar në kapital (RTNct)..... | 8 |
| 3.4 | Qasja e ZRRE në përshtatjen e kostove të bartshme për shkak të Ngjarjes së Jashtëzakonshme..... | 9 |
| 3.5 | Kostot e lejuara të furnizimit me thëngjill (LGScT) | 9 |
| 3.6 | Kostot e Lëndëve të Tjera Djegëse (OTFct) | 10 |
| 3.7 | Kostot e bartshme (PSTct) | 11 |
| 3.8 | Përshtatjet e ri-alokimit të kostove AQ | 12 |
| 3.9 | MAR e Gjeneratorit të Rregulluar - Përmbledhje | 13 |
| 4 | Ngarkesat e Gjeneratorit të Rregulluar | 14 |



Përmbledhje

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) aktualisht është në procesin e Përshtatjeve të Rregullta dhe Azhurnimit Vjetor të të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) të Kompanive të rregulluara në sektorin e Energjisë Elektrike në kuadër të Shqyrtimit të Nëntë të Tarifave të Energjisë Elektrike.

Në kuadër të këtij procesi, ZRRE do të azhurnojë MAR e Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (FPEE) dhe do të përshtatë MAR e Gjeneratorit të Rregulluar (KEK), Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) bazuar në vlerat e caktuara në Shqyrtimin Periodik të bërë në kuadër të Shqyrtimit Shumëvjeçar tarifor SHTE7 (2013-2017).

Ky Raport Konsultativ paraqet vlerësimin e ZRRE-së të të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) të Gjeneratorit të Rregulluar. Së bashku me këtë raport, ZRRE do të publikojë vlerësimet e saj për MAR të KOSTT, OSSH dhe FPEE.

Komentet e palëve të interesit

ZRRE beson fuqimisht se konsultimi publik qëndron në thelb të politikave efektive rregullative. Me këtë, ZRRE i jep Kompanive të Rregulluara dhe Konsumatorëve mundësinë të shqyrtojnë të dhënat dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë Raport Konsultativ, me të cilat ata mund të mos pajtohen, dhe t'i komentojnë ato duke përmirësuar gabime eventuale, duke dhënë kundër-argumente apo duke ofruar të dhëna të reja të cilat ZRRE mund të mos i ketë konsideruar. Palët të cilat dëshirojnë të shprehin mendimin e tyre mbi qëndrimet e ZRRE, ftohen ti dorëzojnë komentet e tyre me shkrim në ero.pricing-tariffs@ero-ks.org jo më vonë se 23 mars 2015. Gjithashtu, komentet mund të dërgohen edhe me postë tek:

Zyra e Rregullatorit për Energji
Departamenti për Tarifa dhe Çmime
Rr. Dervish Rozhaja Nr. 12
Prishtinë, 10000, Kosovë

Dokumente Relevante

| | |
|---|---|
| Vlerësimi fillestar i ZRRE-së të formularëve të raportimit të KEK-ut, të dorëzuara në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik | http://ero-ks.org/Price%20and%20Tariffs/2012/albanian/Vleresimi_fillestar_KEK_shqip.pdf |
| Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së të MAR të KEK-ut në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar | http://ero-ks.org/Tarifat/2012/Vleresim_i_perkoshem_KEK_Gjenerim.pdf |
| Vlerësimi përfundimtar i MAR të KEK-ut në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar | http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/Vleresimi_perfundimtar_per_Gjenerim_22Mars2013.pdf |
| Raporti Konsultativ i Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm nga ZRRE | http://ero-ks.org/Tarifat/2014/Raport_vleresues_shqyrtimi_i_jashtzakonshem_10_8_2014.pdf |
| Aplikacioni i KEK-ut për MAR të Rregulluar, i dorëzuar në kuadër të Përshtatjes së Rregullt 3 | |



(SHTE9)

1 Pasqyrë e Përcaktimit të Çmimit

ZRRE është institucion i pavarur i cili, ndër të tjera, bënë përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për kompani të rregulluara të cilat operojnë në tregun e rregulluar të energjisë elektrike në Kosovë. Idealisht, ZRRE do të përcaktonte vetëm rregullimin e çmimeve dhe tarifave për ato segmente të sektorit të energjisë elektrike të cilat janë monopole natyrale (rrjetet e Transmisionit dhe Shpërndarjes). Megjithatë, pasi që konkurrenca në Gjenerim dhe Furnizim ende nuk është zhvilluar në nivelin i cili do të aplikonte çmime konkurruese, ZRRE i rregullon këto segmente poashtu, duke caktuar tarifa të cilat imitojnë konkurrencën.

Rregullimi i çmimit është mjet që përdoret nga ZRRE në mënyrë që të caktohet shuma e parave (Të Hyrat Maksimale të Lejuara – MAR), të cilën kompanitë e rregulluara lejohen ta mbledhin përmes tarifave për ofrimin e shërbimeve të rregulluara. MAR caktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike duke analizuar hollësisht shpenzimet dhe investimet të cilat Kompanitë planifikojnë t'i realizojnë përgjatë kohës së rregullimit të çmimit. Niveli i MAR përcaktohet për të licencuarit në mënyrë që të kenë mundësi t'i mbulojnë kostot e arsyeshme operative dhe të mirëmbajtjes së impianteve dhe të fitojnë kthim të arsyeshëm në kapital nëse i realizojnë investimet e aprovuara fillimisht. Gjithashtu, ZRRE përcakton caqe të efikasitetit, të cilat synojnë të ngrisin efikasitetin operativ të kompanive dhe të ofrojnë stimulime nëse ato arrijnë nivelin e caqeve apo ndëshkime nëse kompanitë dështojnë t'i arrijnë këto caqe.

Shqyrtimi i fundit Periodik është bërë nga ZRRE në vitin 2012/2013 (SHTE7) dhe ka caktuar MAR e Gjeneratorit të rregulluar për një periudhë katër vjeçare, deri më 2016. Duke e kuptuar nevojën për programe intensive të investimeve kapitale që nevojiten për të përmirësuar sigurinë e furnizimit dhe për të mirëmbajtur infrastrukturën e vjetruar të gjenerimit dhe mihjeve, ZRRE ka aprovuar planin e Gjeneratorit të Rregulluar për të investuar mbi 284 milionë Euro në aktivitetet e tij të Gjenerimit dhe Mihjeve në katër vitet e ardhshme deri në 2016. Një përshkrim i shkurtër në vlerat e lejuara të SHTE7 është dhënë më poshtë:

Tabela 1 SHTE7 MAR i KEK-ut

| KEK Mihjet | KEK Gjenerimi |
|--|--|
| €127.9 milionë në investime përgjatë 4 vjetëve | €156.3 milionë në investime përgjatë 4 vjetëve |
| Projektet kyçe përfshijnë investime në makineri të rëndë, riparimin e dy ekskavatorëve dhe ndërtimin e shiritave transportues për minierën e re në Sibovcin Jug-Perëndimor | Projektet kyçe përfshijnë rregullimin kapital të njësisë A3, B1 dhe B2, Transportin Hidraulik të Hirit për Kosovën A dhe një shtresë të jashtme të re për turbinën me presion të lartë në njësinë B1 |



Faktori vjetor i efikasitet prej 4% i aplikuar në të gjitha kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes së Minierës përgjatë katër viteve

Faktori vjetor i efikasitet prej 4% i aplikuar në të gjitha kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes së Gjeneratorit të Rregulluar përgjatë katër viteve

2 Hyrje

Procesi i Shqyrtimit Periodik, i zhvilluar nga ZRRE në 2012/2013, kishte caktuar MAR e Gjeneratorit të Rregulluar për një periudhë katër vjeçare deri më 2016. Sipas Rregullës për Çmime të Gjenerimit, brenda secilit nga këto katër vite në mes 2013 dhe 2016, ZRRE zhvillon një proces të “Përshtatjeve të Rregullta”. Ky proces ndryshon nga Shqyrtimi Periodik në atë që Përshtatjet e Rregullta nuk ngërthejnë një analizë të detajuar të planeve të investimit dhe kostove operative dhe të mirëmbajtjes. Në vend të asaj, Përshtatjet e Rregullta përdorin rezultate të dalura nga procesi i Shqyrtimit Periodik dhe e përshtatin MAR-in që të reflektojë ndryshimet në mes të kostove të parashikuara gjatë Shqyrtimit Periodik dhe kostot aktuale të realizuara nga të licencuarit për shkak të arsyeve jashtë kontrollit të të licencuarit. Gjatë procesit të Përshtatjes së Rregullt, ZRRE do të:

1. Indeksojë kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes të Gjeneratorit të Rregulluar të lejuara paraprakisht për të reflektuar Faktorin e Efikasitetit të caktuar gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik dhe Inflacionin Vjetor, i cili është i caktuar duke u bazuar në Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – për të gjitha njësitë në Eurozonë;
2. Azhurnojë Koston e lejuar të furnizimit me thëngjill (LGSC);
3. Azhurnojë Kostot e Lëndëve të Tjera Djegëse (OTFC);
4. Azhurnojë Kostot e bartshme;
5. Caktojë Cakun e Disponibilitetit të Gjeneratorit të Rregulluar;
6. Caktojë ngarkesat të Energjisë dhe Kapacitetit të Gjeneratorit të Rregulluar;

Ky Raport është i strukturuar si vijon:

- Pjesa 3 cakton propozimin e ZRRE-së për MAR e Gjeneratorit të rregulluar;
- Pjesa 4 cakton propozimin e ZRRE-së për ngarkesat e Gjeneratorit të rregulluar;

3 Vlerësimi i ZRRE-së për MAR e Gjeneratorit të Rregulluar

Gjatë Përshtatjeve të Rregullta, ZRRE cakton ndryshimin e lejuar në të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) të Gjeneratorit të Rregulluar. Ky ndryshim i lejuar në MAR llogaritet në bazë të formulës së dhënë në Shtojcën 1 paragrafi 2 të Rregullës për Çmime të Gjenerimit:

$$MAR_t = OPMC_t + DEPC_t + RTNC_t + LGSC_t + OTFC_t + PSTC_t$$

Ku

MAR_t paraqet Të hyrat e Lejuara Maksimale në vitin relevant t

$OPMC_t$ paraqet Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t



| | |
|----------|---|
| $DEPC_t$ | <i>paraqet Zhvlerësimin e lejuar në vitin relevant t</i> |
| $RTNC_t$ | <i>paraqet Kthimin e lejuar në kapital në vitin relevant t</i> |
| $LGSC_t$ | <i>paraqet Kostot e lejuara të furnizimit të thëngjillit në vitin relevant t</i> |
| $OTFC_t$ | <i>paraqet Kostot e lejuara të furnizimit me lëndë tjetër djegëse në vitin relevant t</i> |
| $PSTC_t$ | <i>paraqet Kostot e bartshme në vitin relevant t</i> |

3.1 Kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes (OPMCt)

Kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes të Gjeneratorit të Rregulluar ri-caktohen gjatë Përshtatjeve të Rregullta sipas formulës në Shtojcën 1 paragrafi 2.1 të Rregullës për Çmime të Gjenerimit:

$$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$$

Ku

| | |
|--------------|--|
| $OPMC_t$ | <i>paraqet kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t</i> |
| $OPMC_{t-1}$ | <i>paraqet kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t-1, përveç vitit relevant 1, ku do të përdoret vlera e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimit më të fundit periodik</i> |
| CPI_{t-1} | <i>paraqet Vlerën aktuale të inflacionit në vitin relevant t-1, të matur duke përdorur "Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë në Eurozonë" të publikuara nga Eurostat-i, apo ndonjë masë tjetër e inflacionit që rregullatori e përcakton të jetë si masa më e mirë e ndryshimit për kostot operative dhe të mirëmbajtjes përgjatë kohës dhe që është e lejuar gjatë shqyrtimit periodik</i> |
| E_t | <i>paraqet Faktorin e Efikasitetit në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimeve periodike</i> |
| P_t | <i>paraqet Faktorin profilizues në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimeve periodike</i> |

3.1.1 Norma e aplikueshme e inflacionit

ZRRE ka caktuar normën e aplikueshme të inflacionit për indeksimin e OPMC_t të lejuar sipas Indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) për të gjitha njësitë në Eurozonë e marrë nga Eurostat-i, i cili është 0.43% për vitin 2014.

KEK ka përsëritur kërkesën që të zvogëlohet faktori i efikasitetit i aplikuar në kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes nga 4%, siç ishte caktuar fillimisht nga ZRRE, në 1%. KEK pretendon se janë të paaftë të zbatojnë cakun, pasi që kjo do të përfshinte një reduktim domethënës të kuadrove të punësuar. Ata argumentojnë se kjo nuk është e mundur pasi që shumica e kuadrove të kualifikuara kanë lëvizur në KEDS pas shthurjes dhe pasi që, si ndërmarrje publike, një barrë e përgjegjësisë sociale është e vendosur



mbi ata padrejtësisht. Propozimi i tyre për OPMCt është llogaritur me supozimin se ZRRE e pranon kërkesën e tyre për të zbritur faktorin e efikasitetit në 1%.

ZRRE thekson se faktori i efikasitetit ka qenë i përcaktuar bazuar në vlerat e diskutuara publikisht gjatë Shqyrtimit Periodik dhe reflekton një cak i cili është vendosur pas studimeve të hollësishme dhe krahasimin e kompanive të ngjashme të vendeve tjera. ZRRE e kupton se një barre e përgjegjësisë sociale është vendosur padrejtësisht mbi KEK-un, por nuk mund të pranojë që konsumatorët të ngarkohen me këto koston për shkak të këtyre arsyeve. Prandaj, ZRRE do të vazhdojë të aplikojë faktorin vjetor të efikasitetit për shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes prej 4% dhe ka azhurnuar kostot e lejuara që të reflektojnë këtë qëndrim.

3.1.2 Aplikimi i faktorit të efikasitetit në kostot OTFct të KEK-ut

KEK kishte shënuar në aplikacionin e tyre SHTE8 se ZRRE kishte aplikuar faktorin e efikasitetit në Kostot e lëndëve të tjera djegëse (OTFct) në mënyrë të gabuar, duke pritur në këtë mënyrë nga KEK-u të rrisin efikasitetin e tyre në një pikë kostoje mbi të cilën ata nuk kishin kontroll. Ndikimi pasues në MAR të KEK-ut ishte një ulje prej 0.3 milionë Euro, të cilën ZRRE e pranoi dhe kompenzoi retroaktivisht.

ZRRE ka azhurnuar këtë vlerë dhe nuk aplikon faktorin e efikasitetit të lëndëve të tjera djegëse (OTFct) të lejuara për Periudhën e mbetur Rregullative.

3.1.3 Vlerësimi final i ZRRE-së të komponentës së OPMCt

Formula e llogaritjes se koston Operative dhe të Mirëmbajtjes e dhënë në Shtojcën 1 Paragrafi 2.1 të Rregullës, supozon se OPMCt e lejuar është profilizuar¹ gjatë Periudhës Rregullative, ashtu që vlera e OPMCt në cilindo vit relevant të llogaritet duke indeksuar vlerën e OPMCt të vitit paraprak relevant. Pasi që ZRRE ka vlerësuar se nuk duhet aplikuar profilizimi në OPMCt në gjatë Periudhës Rregullative. ZRRE do të aplikojë formulën në vijim:

$$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (CPI_{t-1}) * (1 - E_t) + OPMC_t$$

Kostot finale Operative dhe të Mirëmbajtjes të cilat KEK-u lejohet t'i rimarrë gjatë vitit të tretë relevant rezultojnë të jenë 19.94. milionë Euro.

3.2 Zhvlerësimi i lejuar (DEPCt)

Zhvlerësimi i lejuar i Gjeneratorit të Rregulluar ripërcaktohet gjatë secilës Përshtatje të Rregullt sipas Paragrafit 2.2 të Shtojcës 1 të Rregullës për Çmime të Gjenerimit:

$$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$$

Ku

DEPC_t paraqet zhvlerësimin tjetër të lejuar në vitin relevant t, i cili zbutet (sheshohet) ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullative

¹ ZRRE mund ta aplikoj faktorin profilizues në mënyrë që të minimizojë ndryshime të konsiderueshme në mes të vitit të fundit të periudhës së tanishme rregullative dhe vitit të parë të periudhës së ardhshme rregullative.



| | |
|--------------|--|
| $DEPC_{t-1}$ | <i>paraqet zhvlerësimin e lejuar në vitin relevant t-1, përveç vitit relevant 1 ku do të përdoret vlera e përcaktuar nga Rregullatori gjatë shqyrtimit më të fundit periodik, e cila zbutet (sheshohet) ashtu që të jetë konstante përgjatë periudhës rregullative</i> |
| CPI_{t-1} | <i>paraqet vlerën aktuale të inflacionit në vitin relevant t-1, matur duke përdorur "Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën" publikuar nga Eurostat-i</i> |
| P_t | <i>paraqet faktorin profilizues në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimeve periodike</i> |

Siç është rasti me kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes, formula e përmendur më lartë supozon se DEPC-të e lejuara janë të profilizuara përgjatë Periudhës Rregullative, ashtu që DEPC e lejuar në cilindo vit të mund të llogaritet duke indeksuar vlerën e njëjtë të lejuar të vitit paraprak. Pasi që ZRRE nuk ka profilizuar zhvlerësimin e lejuar në Shqyrtimin e tyre Periodik. ZRRE ka aplikuar formulën në vijim për azhurnimet e rregullta vjetore të zhvlerësimit:

$$DEPC = DEPC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + DEPC_t$$

Zhvlerësimi i lejuar rezulton të jetë 23.25 milionë Euro.

3.3 Kthimi i lejuar në kapital (RTNC_t)

Komponenta e kthimit të lejuar të të Hyrave Maksimale të Lejuara të Gjeneratorit të rregulluar është llogaritur sipas formulës së dhënë në paragrafin 2.3 të Shtojcës 1 të Rregullës:

$$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$$

Ku

| | |
|--------------|---|
| $RTNC_t$ | <i>është kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant t, i cili zbutet (sheshohet) ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullative</i> |
| $RTNC_{t-1}$ | <i>është kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant t-1, përveç vitit relevant 1, ku do të përdoret vlera e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimit më të fundit periodik, e cila zbutet ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullative</i> |
| CPI_{t-1} | <i>është vlera aktuale e inflacionit në vitin relevant t-1, matur duke përdorur "Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën" publikuar nga Eurostat-i</i> |
| P_t | <i>është faktori profilizues në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimeve periodike</i> |

Në mënyrë që të korrigjohet për faktin që ZRRE nuk e ka profilizuar Kthimin e Lejuar përgjatë Periudhës Rregullative siç është shpjeguar në Pjesët 3.2 dhe 3.3 më lartë, ZRRE do të aplikojë formulën në vijim:



$$RTNC = RTNC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + RTNC_t$$

Komponenta e Kthimit të Lejuar të MAR të Gjeneratorit të Rregulluar rezulton të jetë 9.27 milionë Euro.

3.4 Qasja e ZRRE në përshtatjen e kostove të bartshme për shkak të Ngjarjes së Jashtëzakonshme

Të Hyrat Maksimale të Lejuara të Gjeneratorit të Rregulluar për Vitin e Dytë Relevant (SHTE8) të Periudhës Rregullative fillimisht ishin caktuar të jenë 139.5 milionë Euro, të parashikuara t'i mbulojnë shpenzimet për ofrimin e nivelit të prodhimit prej 5,525 GWh.

Megjithatë, shpërthimi i cili ndodhi më 6 qershor 2014 në Kosovën A, e reduktoi dukshëm nivelin e prodhimit të cilin KEK pritej të realizonte (një reduktim prej 427 GWh nën supozimin se njësitë gjeneruese do të ktheheshin në operim në fund të vitit 2014). KEK dorëzoi një kërkesë për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm në mënyrë që të mbulojë kostot e riparimit dhe kostot e lidhura me humbjen e shitjeve si rezultat i reduktimit. Megjithatë, KEK nuk ishte në gjendje të dëshmonte për ZRRE se ngjarja e jashtëzakonshme (shpërthimi) ishte jashtë kontrollit të tyre, siç parashihet në Rregullën për përcaktimin e çmimeve të gjenerimit. Përmë tepër, deri më tani ZRRE nuk ka pranuar raportin zyrtar nga organet shtetërore të hetuesisë për shkaqe të shpërthimit në Kosovën A. Për këtë arsye në Vitin e Dytë të Periudhës Rregullative këtë arsye, ZRRE nuk i ka përshtatur ngarkesat e KEK-ut që të reflektojnë nivelin e ri të prodhimit dhe në caktimin e Kostove të Shitjeve me Shumicë të Energjisë (WHPC) të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike, ka supozuar se MAR-i i Gjenerimit pas shpërthimit do të ishte 128.7 milionë Euro me nivel të parashikuar të ri të prodhimit prej 5,098 GWh.

Në mënyrë që të llogariten përshtatjet për Vitin e Tretë Relevant, ZRRE ka ripërcaktuar Kostot e Lejuara të Furnizimit me Thëngjill (LGSCt), Kostot e bartshme (PSTCt) dhe Kostot e lëndëve të tjera djegëse (OTFCt) të Gjeneratorit të Rregulluar që të përputhen me nivelin e ri të prodhimit prej 5,098 GWh në bazë *pro-rata*. Rezultatet e llogaritjeve të detajuara janë dhënë në pjesët relevante më poshtë.

3.5 Kostot e lejuara të furnizimit me thëngjill (LGSCt)

Në mungesë të një marrëveshjeje për furnizim me thëngjill në mes të Gjenerimit dhe Minierës për gjeneratorët e rregulluar Kosova A dhe Kosova B, ZRRE është e obliguar që të përcakton koston e furnizimit me thëngjill për gjeneratorët e rregulluar, Kosova A dhe Kosova B në bazë të Rregullës për përcaktim të çmimeve të gjenerimit.

Pra kostoja e minierave përbën pjesën kryesore në koston e Gjeneratorëve të Rregulluar në Kosovë, ZRRE e rregullon këtë kosto nga perspektiva e Gjeneratorit.

ZRRE ka aplikuar të njëjtat principe sikurse në pjesën 3.1 për llogaritjen e vlerave të lejuara të OPMCT, DEPCT dhe RTNCt për Divizionin e Minierave të KEK-ut. Kostot e bartshme të minierës janë përshtatur që të reflektojnë diferencën në mes të Vlerës së Lejuar nga Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm dhe Vlerës Aktuale të raportuar nga KEK-u. ZRRE ka aplikuar formulën 2.4 e Shtojcës 1 të Rregullës për Çmimet e Gjenerimit:

$$LGSC_t = LGSCf_t + (LGSCa_{t-1} - LGSCf_{t-1}) * (1 + I_t)$$

Ku



| | |
|---------------|---|
| $LGSC_t$ | është kosto e lejuar e furnizimit me thëngjill në vitin relevant t |
| $LGSCa_{t-1}$ | është kostoja e lejuar e furnizimit me thëngjill e realizuar në vitin relevant $t-1$ |
| $LGSCf_{t-1}$ | është kostoja e lejuar e furnizimit me thëngjill e parashikuar në vitin relevant $t-1$ |
| I_t | është norma e interesit për vitin relevant t , që llogaritet në bazë të EURIBOR-it plus 5%, ku S është vlera që caktohet nga Rregullatori gjatë shqyrtimeve periodike dhe e cila reflekton preminë që duhet paguar nga i licencuari për kredi afat-shkurtra mbi normën e EURIBOR-it |

Të dhënat dhe rezultatet nga kalkulimet e formulës së përmendur më lartë janë dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 2 Llogaritja e Kostove të lejuara të furnizimit me thëngjill (LGSCt)

| Kostot e lejuara të furnizimit me thëngjill në vitin relevant t | LGSCt | 81,245,989 |
|--|----------|------------|
| Kosto e lejuar e furnizimit me thëngjill e parashikuar në vitin relevant t | LGSCft | 79,312,873 |
| Kosto e lejuar e furnizimit me thëngjill e realizuar në vitin relevant $t-1$ | LGSCat-1 | 74,870,926 |
| Kosto e lejuar e furnizimit me thëngjill e parashikuar në vitin relevant $t-1$ | LGSCft-1 | 73,197,043 |
| Norma e interesit për vitin relevant t | I_t | 15.49% |

3.6 Kostot e Lëndëve të Tjera Djegëse (OTFCt)

ZRRE ka aplikuar formulën e cekur në Paragrafin 2.5 të Shtojcës 1 të Rregullës për Çmimet e Gjenerimit për të llogaritur Kostot e lëndëve të tjera djegëse të Gjeneratorit të rregulluar:

$$OTFC_t = OTFCf_t + (OTFCa_{t-1} - OTFCf_{t-1}) * (1 + I_t)$$

Ku

| | |
|---------------|---|
| $OTFC_t$ | është kostoja e lejuar e furnizimit me lëndë të tjera djegëse për vitin relevant t |
| $OTFCa_{t-1}$ | është kostoja e lejuar e furnizimit me lëndë të tjera djegëse e realizuar në vitin relevant $t-1$ |
| $OTFCf_{t-1}$ | është kostoja e lejuar e furnizimit me lëndë të tjera djegëse e parashikuar në vitin relevant $t-1$ |
| I_t | është norma e interesit për vitin relevant t , që llogaritet në bazë të EURIBOR-it plus 5%, ku S është vlera që caktohet nga Rregullatori gjatë shqyrtimeve periodike dhe e cila reflekton preminë që duhet paguar nga i licencuari për kredi afat-shkurtra mbi normën e EURIBOR-it |



Të dhënat dhe rezultatet nga kalkulimet e formulës së përmendur më lartë janë dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 3 Llogaritja e Kostove të furnizimit me lëndë të tjera djegëse

| Kostot e lejuara të furnizimit me lëndë të tjera djegëse për vitin relevant t | OTFCt | 4,410,799 |
|---|--------------|------------------|
| Kosto e lejuar e furnizimit me lëndë të tjera djegëse e parashikuar në vitin relevant t | OTFCft | 8,261,669 |
| Kosto e lejuar e furnizimit me lëndë të tjera djegëse e realizuar në vitin relevant t-1 | OTFCat-1 | 4,288,866 |
| Kosto e lejuar e furnizimit me lëndë të tjera djegëse e parashikuar në vitin relevant t | OTFCft-1 | 7,623,328 |
| Norma e interesit për vitin relevant t | It | 15.49% |

3.7 Kostot e bartshme (PSTCt)

ZRRE ka aplikuar formulën e cekur në Paragrafin 2.6 të Shtojcës 1 të Rregullës për Çmimet e Gjenerimit për të llogaritur Kostot e bartshme të Gjeneratorit të rregulluar:

$$PSTC_t = PSTCf_t + (PSTCa_{t-1} - PSTCf_{t-1}) * (1 + I_t)$$

Ku

PSTC_t janë kostot e bartshme në vitin relevant t

PSTCa_{t-1} janë kostot e bartshme aktuale në vitin relevant t-1

PSTCf_{t-1} janë kostot e bartshme të parashikuara për vitin relevant t-1

I_t është norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet në bazë të EURIBOR-it plus 5%, ku S është vlera që caktohet nga Rregullatori gjatë shqyrtimeve periodike dhe e cila reflekton preminë që duhet paguar nga i licencuari për kredi afat-shkurtra mbi normën e EURIBOR-it

Të dhënat dhe rezultatet nga kalkulimet e formulës së përmendur më lartë janë dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 4 Llogaritja e Kostove të bartshme

| Kostot e bartshme në vitin relevant t | PSTCt | 3,590,495 |
|--|--------------|------------------|
| Kostot e bartshme të parashikuara për vitin relevant t | PSTCft | 4,125,819 |
| Kostot e bartshme aktuale në vitin relevant t-1 | PSTCat-1 | 3,165,433 |
| Kostot e bartshme të parashikuara për vitin relevant t-1 | PSTCft-1 | 3,628,968 |
| Norma e interesit për vitin relevant t | It | 15.49% |



3.8 Përshtatjet e ri-alokimit të kostove të AQ

Gjatë shqyrtimit periodik SHTE7, ZRRE ka ndarë kostot totale të lejuara të Administratës Qendrore (AQ) në mes KEK-ut dhe KEDS-it sipas një faktori të alokimit bazuar në numrin e punëtorëve. Shpenzimet totale të AQ të kërkuara nga të licencuarit me aplikacionin për SHTE7 kanë qenë, mesatarisht, € 11.9 milion në vit, megjithatë ZRRE ka vlerësuar se vlerat e lejuara duhet të jenë € 10.8 milion. Vlerat e lejuara janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 5 Lejimet e kostove të AQ me SHTE7 (€'000)

| Divizioni | Numri i punëtorëve | Alokimi i kostove të AQ në bazë të numrit të punëtorëve | | | | |
|-------------|--------------------|---|-------------|-------------|-------------|-------------|
| | | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 |
| Shpërndarja | 1,045 | € 1,720.92 | € 1,720.92 | € 1,720.92 | € 1,720.92 | € 1,721.71 |
| Miniera | 3,177 | € 4,912.32 | € 4,912.32 | € 4,912.32 | € 4,912.32 | € 4,914.59 |
| Gjenerimi | 1,492 | € 2,431.59 | € 2,431.59 | € 2,431.59 | € 2,431.59 | € 2,432.71 |
| Furnizimi | 1,272 | € 1,768.17 | € 1,768.17 | € 1,768.17 | € 1,768.17 | € 1,768.99 |
| | 6,986 | € 10,833.00 | € 10,833.00 | € 10,833.00 | € 10,833.00 | € 10,838.00 |

Megjithatë zhvendosja e të punësuarve në mes KEK-ut dhe KEDS-it ndryshoi pas shthurjes së KEDS-it. Alokimi përfundimtar i kostove të AQ mes KEK-ut dhe KEDS-it është vendosur në një marrëveshje të veçantë ndërmjet dy entiteteve. Sipas kësaj marrëveshjeje, KEK dhe KEDS do të ndajnë kostot e lejuara të AQ mbi një bazë të ndarjes 46,1%, përkatësisht 53,9%. Prandaj ZRRE-ja ishte e detyruar që në mënyrë retroaktive të ndajë shpenzimet AQ për vitin 2013 dhe 2014 për të kompensuar për ndryshimet ndërmjet vlerave të përcaktuara gjatë Shqyrtimit Periodik dhe vlerave të marrëveshjes. Sipas përshtatjeve të SHTE8, ZRRE-ja ka marrë parasysh faktorët e rinj të alokimit të përcaktuar nga marrëveshja, megjithatë, kur ajo ka llogaritur lejimet, ka mbivlerësuar lejimin e KEK-Furnizimi dhe Shpërndarja për € 0.06 milion dhe nënvlerësuar lejimet e KEK-Gjenerimit për € 0.2 milion euro. Ky ndryshim, së bashku me interesin e lidhur, gjithashtu do të kompensohen me SHTE9. Rrjedhimisht, MAR i KEK-ut është rritur për € 0.2 milion, ndërsa MAR i KEDS-it është ulur për € 0.1 milion. Ky rialokim i kostove të AQ për të licencuarit nuk ndikim në tarifën e konsumatorëve të rregulluar tarifor.

Tabela në vijim përmbledh vlerat të cilat janë të lejuara nga ZRRE-ja sipas shqyrtimit SHTE7 dhe ato që duhet të ishin lejuar sipas marrëveshjes së KEK-KEDS:



Table 6 Alokimi i kostove bazuar në marrëveshjen KEK-KEDS

| | | <i>Alokimi i kostove të AQ në bazë të numrit të punëtorëve</i> | | | | |
|--|---|--|--------------|------------|------------|------------|
| | | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 |
| | | '000 | '000 | '000 | '000 | '000 |
| <i>(A) Vlerat të cilat do duhej të ishin lejuar (në bazë të marrëveshjes KEK-KEDS)</i> | | | | | | |
| KEK | € | 4,994.01 | € 4,994.01 | € 4,994.01 | € 4,994.01 | € 4,996.32 |
| KEDS | € | 5,838.99 | € 5,838.99 | € 5,838.99 | € 5,838.99 | € 5,841.68 |
| <i>(B) Vlerat e lejuara nga ZRRE (pa interes)</i> | | | | | | |
| KEK | € | 7,343.91 | € 4,798.66 | | | |
| KEDS | € | 3,489.09 | € 5,904.26 | | | |
| <i>A-B = Ndryshimi (kompensimi në mes KEK-ut dhe KEDS pa interes)</i> | | | | | | |
| KEK | - | | € (2,349.90) | € 260.63 | | |
| KEDS | - | | € 2,349.90 | € (130.5) | | |

3.9 MAR e Gjeneratorit të Rregulluar - Përmbledhje

Tabela 7 Përmbledhje e MAR e Gjeneratorit të Rregulluar

| Kategoria | Njësia | 2015 |
|---|----------|-------------------|
| Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t | OPMct | 19,945,326 |
| Vlera aktuale e inflacionit në vitin relevant t-1 | CPIt-1 | 0.043% |
| Faktori i efikasitetit në vitin relevant t-1 | Et | 4% |
| Zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant t | DEPct | 23,247,841 |
| Vlera aktuale e inflacionit në vitin relevant t-1 | CPIt-1 | 0.43% |
| Kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant t | RTNct | 9,269,086 |
| Vlera aktuale e inflacionit në vitin relevant t-1 | CPIt-1 | 0.43% |
| Kostot e lejuara të furnizimit me thëngjill në vitin relevant t | LGSCt | 81,245,989 |
| Kostot e lejuara të furnizimit me thëngjill të parashikuara në vitin relevant t | LGSCft | 79,312,873 |
| Kostot e lejuara të furnizimit me thëngjill të realizuara në vitin relevant t-1 | LGSCat-1 | 74,870,926 |
| Kostot e lejuara të furnizimit me thëngjill të parashikuara në vitin relevant t-1 | LGSCft-1 | 73,197,043 |
| Norma e interesit për vitin relevant t | It | 15.49% |
| Kostot e lejuara të furnizimit me lëndë të tjera djegëse | OTFCt | 4,410,799 |



për vitin relevant t

| | | |
|--|----------|------------------|
| Kostot e lejuara të furnizimit me lëndë të tjera djegëse të parashikuara në vitin relevant t | OTFCft | 8,261,669 |
| Kostot e lejuara të furnizimit me lëndë të tjera djegëse të realizuara në vitin relevant t-1 | OTFCat-1 | 4,288,866 |
| Kostot e lejuara të furnizimit me lëndë të tjera djegëse të parashikuara në vitin relevant t-1 | OTFCft-1 | 7,623,328 |
| Norma e interesit për vitin relevant t | It | 15.49% |
| Kostot e bartshme në vitin relevant t | PSTCt | 3,590,495 |
| Kostot e bartshme të parashikuara për vitin relevant t | PSTCft | 4,125,819 |
| Kostot e bartshme aktuale për vitin relevant t | PSTCat-1 | 3,165,433 |
| Kostot e bartshme të parashikuara për vitin relevant t-1 | PSTCft-1 | 3,628,968 |
| Norma e interesit për vitin relevant t | It | 15.49% |
| <hr/> | | |
| Kostot e sigurimit shëndetësor | | 702,637 |
| Të hyrat nga hiri TC B | | -1,944,410 |
| Të hyrat nga koogjenerimi TC B | | -1,178,977 |
| Të hyrat nga mbeturinat e metalta TC A | | -1,063,039 |
| Alokimi i kostove të AQ për TC A&B | | 300,995 |

Të Hyrat Maksimale të Lejuara në vitin relevant t MART **140,276,742**

4 Ngarkesat e Gjeneratorit të Rregulluar

ZRRE ka vlerësuar se kostot fikse përbejë 68% të kostove të tale të Gjenerimit, ku përfshihen shpenzimet operative, zhvlerësimi dhe kthimi si komponentë kryesore, kundrejt atyre të ndryshueshme prej 32% ku përfshijnë lëndet djegëse dhe një pjese të konsiderueshme të kostove të thëngjillit si dhe kostot e barrshme në llogaritjen e ngarkesës së kapacitetit dhe energjisë të Gjeneratorit të rregulluar. Të dhënat e disponibilitetit dhe prodhimit janë marrë nga nivelet e parashikuara të prodhimit të KEK-ut në 2015.

Rezultatet e kalkulimeve janë dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 8 Llogaritja e Ngarkesës së Energjisë dhe Kapacitetit të Gjeneratorit të Rregulluar

| Kategoria | Njësia | 2015 |
|---|---------------|--------------|
| Të Hyrat Maksimale të Lejuara në vitin relevant t – Kostot fikse | | 95,388,185 |
| Të Hyrat Maksimale të Lejuara në vitin relevant t – Kostot e ndryshueshme | | 44,888,557 |
| Të Hyrat Maksimale të Lejuara në vitin relevant t | | 140,276,742 |
| Kapaciteti i parashikuar i disponueshëm në vitin relevant t | MW/h | 5, 298,802 |
| Shitjet e energjisë të parashikuara në vitin relevant t | MWh | 5,298,802 |
| Ngarkesa e kapacitetit | €/MW/h | 18.00 |
| Ngarkesa e energjisë | €/MWh | 8.47 |
| Ngarkesat mesatare | €/MWh | 26.47 |